



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:077771

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06781043

2019:077771

(P.nr.287/19)

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.R. nga fsh., për shkak të veprës penale Vjedhje e Shërbimeve nga neni 320 të Kodit Penal të Kosovës (KPPK-së), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II nr. 446-3/19, të dt.27.02.2019, konform nenit 106 par. 1 pika 5 të KPPK-së dhe nenit 248 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, me dt.30.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

Hudhët aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II nr. 446-3/19, e dt.27.02.2019, ndaj të pandehurit G. R., nga i ati M., i lindur më, me vendbanim në fsh. . K....., nr. personal, për shkak të veprës penale Vjedhje e Shërbimeve nga neni 320 të KPPK-së, dhe pushohet procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II nr. 446-3/19, të dt.27.02.2019, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të veprës penale Vjedhje e Shërbimeve nga neni 320 të Kodit Penal të Kosovës (KPPK-së) dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Nga dispozitivi i aktakuzës rezulton se vepra penale është kryer prej datës 26.10.2018 deri më datë 08.01.2019, dhe për këtë veprë penale Vjedhje e Shërbimeve nga neni 320 të KPRK-së, është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tri) vite.

Në nenin 106 par.1 pikë 5 të KPPK-së, parashihet se ndjekja penale për vepra penale të dënueshme deri 3 (tri) vite burgim, nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati prej 3 /tri/ viteve nga data e kryerjes së veprës penale-parashkrimi relativ, e në rastin konkret janë ndërmarr disa veprime me të cilat është ndërpre parashkrimi relativ, mirëpo deri më datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi tani kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite dhe për këtë ka arritur parashkrimi absolut dhe rrjedhimisht ndjekja penale më nuk mund të ndërmerret për shkak se ka ndodhur parashkrimi absolut i kësaj vepre penale.

Në nenit 107 pika. 8 të KPPK-së, thuhet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale) e që në rastin konkret nga data e kryerjes së veprës penale që është prej datës 26.10.2018 deri më datë 08.01.2019, kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vite, e që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut dhe më nuk mund të bëhet ndjekja penale.

Konform nenit 453 par.1 të KPPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
Komfor nenit 453 par.1 të KPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARATAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI PENAL
2019:077771 (P.nr.287/19) , datë 30.01.2025

Zyrtare ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tri/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.